



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. ____ Prot.

Lezhë, më ____ . ____ .2024

NJOFTIM

PËR ORGANIZMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME RISHIKIMIN E HARTËS SË STACIONEVE TË PLAZHEVE DHE VENDBAZIMEVE UJORE NË VIJEN BREGDETARE SHËNGJIN DHE TALE PËR SEZONIN TURISTIK VEROR 2025

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.9251, date 08/07/2004 “Kodi Detar I Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 Për Miratimin E Rregullores “Për Kushtet Dhe Kriteret E Ushtrimit Të veprimtarisë së stacionit të plazhit” dhe relacionit të administratës së Bashkisë Lezhë ka ndërmarrë nismën për rishikimin e hartës së stacioneve të plazheve dhe vendbazimeve ujore në vijen bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2025.

Konkretisht procesi i rishikimit prek pothuajse të gjithë brezin bregdetar duke ju referuar dhe VKM nr. 649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”. Harta ka zbatuar me rigorozitet kushtet dhe kriteret duke përcaktuar plazhet publike dhe të menaxhuara.

Në vijim të procesit të rishikimit të hartës, Ju ftojme të merrni pjesë në dëgjuesen publike, ditën e martë, **datë 26 Nentor 2024, në ambientet e Sallës së Konferencave Rafaelo, në orën 16:00**. Gjatë takimit do bëhet prezantimi i dokumentave të rishikimit të dakortësuara paraprakisht me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe do të mbahen shënime mendimet Tuaja, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshem, shfrytëzimit të potencialeve, plotësimin e nevojave si dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025.

Bashkëngjitur është harta e stacioneve të plazheve, harta e vendbazimeve, Projekt Vendimi dhe relacioni.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet Tuaja !

**Kryetari
PJERIN NDREU**